

**KOMBET E  
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen  
Penale të Personave Përgjegjës për  
Shkelje të Rënda të së Drejtës  
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera  
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej  
Vitet 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-PT

Data: 2 qershor 2011

Originali: anglisht

**NË DHOMËN GJYQËSORE II**

**Para:** Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Gjykatës Paragjyqësor

**Sekretari:** Z. John Hocking

**Urdhër:** 2 qershor 2011

**PROKURORI**

**kundër**

**RAMUSH HARADINAJT  
IDRIZ BALAJT  
LAHI BRAHIMAJT**

**PUBLIK**

**URDHËR PËR CAKTIM DATE**

**Zyrës së Prokurorit:**

Z. Paul Rogers

**Avokatëve të Mbrojtjes:**

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn

Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen Rohan për Idriz Balajn

Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

**Unë, Bakone Justice Moloto**, Gjykatës i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (“Tribunali”);

**PASI JAM VETËCAKTUAR** Gjykatës Paragjyqësor në këtë çështje;<sup>1</sup>

**DUKE MARRË PARASYSH** paragrafin A të Rregullës 65 *bis* të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit (“Rregullorja”), në bazë të të cilit brenda 120 ditësh prej datës së konferencës së fundit për gjendjen zhvillohet konferencë për gjendjen (i) për organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe (ii) për shqyrtimin e gjendjes ekzistuese së çështjes dhe për t’i dhënë të akuzuarit mundësinë për ngritjen e problemeve në lidhje me çështjen e tij, përfshirë gjendjen e tij mendore dhe fizike;

**DUKE MARRË SHËNIM** se konferenca e fundit për gjendjen u mbajt më 23 shkurt 2011;

**BAZUAR NË** Rregullën 65 *bis* të Rregullores;

**CAKTOJ** zhvillimin e një konference për gjendjen, të enjten, 9 qershor 2011, në orën 15:00, në një sallë gjyqësore caktuar prej Sekretarisë.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/  
Gjykatës Bakone Justice Moloto  
Kryegjykatës

Sot, më datën 2 qershor 2011.  
Në Hagë  
Holandë

**[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]**

---

<sup>1</sup> Urdhër për Caktimin e Gjykatës Paragjyqësor, 6 shtator 2010.